




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.04.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-504/15, për z. Flamur Shala – Anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02- 504/15, për zyrtarin e lartë, z. Flamur Shala – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji PKI).

Në këtë rast z. Shala, është hetuar për konflikt interesi sepse ka marrë pjesë në procedurat e vendimmarrjes në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Prishtinës të datës 14.01.2015 dhe seancën e rregullt të datës 05.02.2015, në të cilat është diskutuar lidhur me shkarkimin dhe emërimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike të Komunës së Prishtinës.

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), i ka dërguar z. Shala shkresën njoftuese për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës kemi organizuar takim në zyrat e AKK-së në të cilin është njoftuar me pretendimet e palës denoncuese në lidhje me situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Në takim dhe nga Ekstrakti i Procesverbalit të Mbledhjeve të Kuvendit Komunal, kemi vërtetuar se së pari janë shkarkuar Anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve ndërsa, më pas është miratuar Vendimi për caktimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale të Prishtinës.

Nuk qëndron pretendimi i denoncuesit të rastit se veprimi i z. Shala paraqet konflikt interesi për shkak se vëllai i tij Afrim Shala, për kohën në të cilën është diskutuar shkarkimi i anëtarëve të Komisioneve Komunale të Aksionarëve, ka qenë anëtar i Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen “Hortikultura”.

Kjo për faktin se Afrim Shala, që nga data 24.11.2014, nuk është pjesë e Bordit të Ndërmarrjes “Hortikultura”.

Kjo vërtetohet edhe me formularin e deklaramit të pasurisë pas largimit nga funksioni të cilin z. Shala e ka dërguar në Agjenci.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

